

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 të datës 01.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.11-2862/1 të datës 23.07.2026, dhe Konkluzionin nr.ark.02-2884/10 të datës 28.07.2026, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjatë seancës së 27-të të mbajtur më 28.07.2026, miratoi:

Aktvendim për paralajmërim publik dhe ndalimin e ritransmetimit të shërbimit programor

1. Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive-operatori i rrjetit kabllor VIVA NET ShPKNJ P Berovë, paralajmërohet publikisht për shkak të ritransmetimit të shërbimit programor që nuk është i regjistruar në Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), në pajtim me nenin 141 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV-së).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me nr.ark.11-2862/1 të datës 23.07.2026, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. **URDHËROHET** që Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive-operatori i rrjetit kabllor VIVA NET ShPKNJ P Berovë, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV, përkatësisht të ndalon ritransmetimin e shërbimit programor.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit për paralajmërim publik dhe për ndalimin me ritransmetim të shërbimit programor.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit, përkatësisht vazhdon të kryejë shkelje për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia, në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 2 nga LShMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente.

5. Ky aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratim llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LShMAAV-së ndërmerr masa në pajtim me këtë ligji në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të LShMAAV-së ose të dispozitave të miratuara në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LShMAAV, Agjencia është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të ligjit, lejet, çertifikatat e lëshuara për regjistrim, aktet nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, në pajtim me nenin 27, dhe nenin 28 të LShMAAV, Agjencia më 22.07.2026, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të paketës programore të ritransmetuar nga operatori Shoqëria Tregtare Radiodifuzive-operatori i rrjetit kabllor VIVA NET ShPKNJ P Berovë, ku është konstatuar se operatori në fjalë i cili sipas notifikacionit nga Agjencia e

Komunikimeve Elektronike, mund të kryejë veprimtari në territorin e komunës së Berovës dhe komunës Pehçevë, me datë 22.07.2026, për përdoruesit e saj ka ritransmetuar shërbimin programor i cili nuk mbulohet me certifikatë për regjistrim të shërbimi programor të dhënë nga Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, që është në kundërshtim me nenin 141, paragrafi (13) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Konstatimet nga mbikëqyrja janë specifikuar detajisht në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.ark.11-2862/1 të datës 23.07.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe nenit 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV-së, dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.11-2862/1 të datës 23.07.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-2884/10 të datës 28.07.2026, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LShMAAV i cekur në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim me të cilin ndaj subjektit të lartpërmendur do të ndërmerret masë paralajmërim publik dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV-së, në mënyrë që do të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhëresës, përkatësisht sipas paralajmërimit publik dhe ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimit programor.

Në pajtim me nenin 24, të LShMAAV-së, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi, operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë të ngrejë padi, për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.ark.11-2862/1 datë 23.07.2026.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës administrative. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani